

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 422 REP.

Nr. 147 KOL.



### KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne Tirane, sot me daten 29.01.2007 (dymije e shtate), para meje noterit Julian ZHELEGU, midis paleve te meposhteme u lidh kjo kontrate shitblerje kuotash:

**SHITES:** Vledin BRAHIMI, i biri i Adilit dhe i Sherifes, i datëlindjes 23.02.1972, lindur në Vlorë dhe me banim në Tiranë në adresën Rruga "Pandi Dardha", Pall.27, Shk.1, Ap.13, i identifikuar me pasaportën nr. Z1681543, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar,

**Blerta BRAHIMI**, e bija e Lavdoshit, e datelindjes 06.02.1977, lindur ne Vlore e banuese ne Tirane, e identifikuar me pasaporten nr. Z1972664, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar,

këtu e më poshtë te quajtur Shitësi,

**BLERES:** Vullnet SINAJ, i biri i Ruzhdiut dhe Lefterisë, i datelindjes 20.08.1965, lindur ne Vlorë dhe banues në Tiranë në adresën Rruga "Naim Frashëri", Pall.47/2, identifikuar me pasaporten Nr.Z0597572, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, këtu e më poshtë I quajtur Blerësi,

**OBJEKTI :** Transferimi nepermjet shitjes i kuotave ne masen 50(pesëdhjetë) perqind, qe Z.Vledin BRAHIMI zoteron ne shoqerine "BASHKIMI" shpk, ne mbeshtetje te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

### PERMBAJTJA E KONTRATES

Shoqeria "BASHKIMI " shpk, eshte regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane, me vendimin Nr.27350, date 08.03.2002.

Me vendimin Nr.1, date 29.01.2007, te Asamblesë së Jashtëzakonshme të ortakëve te shoqerise "BASHKIMI" shpk, eshte vendosur shitja e kuotave ne masen 50(pesëdhjetë) perqind te bleresi Z.Vullnet SINAJ.

**Shitesi**, eshte plotesisht dakord dhe i shet me vullnetin tij te lire dhe te plote bleresit, 50 (pesëdhjetë) perqind te kuotave zoteruese ne kapitalin e shoqerise "BASHKIMI" shpk.



Nga ana e vet Bleresi, eshte plotesisht dakord qe te bleje 50 (pesëdhjetë) perqind te kuotave te shoqerise "BASHKIMI" shpk.

#### **ÇMIMI I SHITJES SE KUOTAVE DHE MENYRA E PAGESES.**

Vlera e shitjes se kuotave ne masen 50 (pesëdhjete) perqind nga shitesi, do te jete e barabarte me nje vlere prej 50.000 (pesëdhjete mije) leke, vlere kjo me te cilen jane vleresuar paketa e kuotave te shitura nga ana e Shitësit, per te cilen eshte rene dakord nga Blerësi.

Pagesa ne shumen e mesiperme eshte bere jashte zyres noteriale dhe ne menyren e pageses sipas marreveshjes se rene dakord ndermjet tyre.

#### **MENYRA E KALIMIT TE PRONESISE SE KUOTAVE.**

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, Shitesi humbet pronesine mbi 50 (pesëdhjete) perqind te kuotave ne kapitalin e shoqerise se mesiperme, duke mos patur ne te ardhmen asnje pretendim pronesie.

Bleresi me nenshkrimin e kesaj kontrate behet pronar i 50 (pesëdhjete) perqind te kuotave ne shoqerine "BASHKIMI" shpk.

Palet deklarojne se nuk i kane njeri – tjetrit asnje pretendim apo detyrim financiar te palikujduar te lindur si rezultat i pozicionit te tyre te meparshem si zoterues aksionesh (fitim vjetor etj.) ne shoqerine "Bashkimi " shpk.

Keshtu, me perfundimin e ketij transaksioni shitje, do te kemi kete gjendje te zoterimit te kuotave ne shoqerine " BASHKIMI" shpk :

1. Z.Vullnet SINAJ do të zotërojë 50 (pesëdhjetë) perqind te kuotave te shoqerise "BASHKIMI" shpk qe perfaqesojne 50.000 (pesëdhjetë mije) leke per kontributin ne para;

Znj.Miranda SINAJ do te zoteroje 50(pesëdhjete) perqind te kuotave te shoqerise "BASHKIMI" shpk qe perfaqesojne 50.000(pesëdhjete mije) leke per kontributin ne para.

2.Shitesi, pas ketij trasaksioni nuk do te zoteroje asnje kuote ne shoqerine "BASHKIMI" shpk.



## KLAUZOLA SHITESE TE KONTRATES

Shpenzimet noteriale, te avokatit dhe ato te depozitimit te akteve ne gjykate, do te perballohen ne menyre te barabarte nga te dyja palet.

Kontrata hartohet ne pese kopje te njejta, nga te cilat nje e mbajne palet, nje kopje depozitohet ne Zyren e Regjistrimit Tregtar, nje kopje depozitohet ne aktet e shoqerise dhe nje kopje prane noterit ku ajo u redaktua.

Termat e kontrates, pasi u redaktuan prej meje noterit, iu bene te njohura paleve kontraktuese, te cilet e nenshkruan ate me vullnetin e tyre te lire dhe te plote ne pranine time.

### SHITES

**VELEDIN BRAHIMI**

*Veledin Brahimi*

**BLERTA BRAHIMI**

*Blerta Brahimi*

### BLERES

**VULLNET SINAJ**

*Vullnet Sinaj*

### NOTERI

**JULIAN ZHELEGU**

*Julian Zhegu*